



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:240279
Datë: 30.05.2023
Numri i dokumentit: 04341575

PKR Nr. 22/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Krimeve të Rënda, Trupi gjykues në përbërje prej Kryetarit të trupit gjykues Murat Hulaj, me anëtarët e trupit gjykues, gjyqtarët profesionist: Ajshe Balaj dhe Arben Mustafaj-anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taranish, në çështjen penale kundër të pandehurit S. F. nga fsh. B., K. Istog, për shkak të dyshimit të bazuar mirë së ka kryer veprat penale: “Vrasje e rëndë e mbetur në tentative”, nga neni 173 par. 1, nën par 1.8, e lidhur me nenin 28 dhe 18, veprë penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par. 1, dhe “Lëndim i lehte trupor”, nga neni 185 par. 3 lidhur me nën par. 3.1 dhe me nenin 18 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Krimeve të Rënda nën shenjen PP/I Nr. 220/2021 të dt. 24.02.2022, pas mbajtjes dhe përfundimit të rishqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 15.05.2023, në prezencën e Prokurores së Shtetit, të pandehurit S. F., mbrojtësit të tij av. Muhamet Ibraj, dhe të dëmtuarve A. F. dhe B. M., si dhe pas mbajtjes së seancës për këshillim dhe votim, me dt. 17.05.2023, morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 30.05.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

S. F., i lindur me dt. në fsh. B, K. Istog, ku edhe banon, nga i ati M. dhe e ëma S. e gjinisë Sh., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, din shkrim-lexim, me profesion vozitës, i identifikuar me nr. personal ., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë nën masën e paraburgimit nga dt. 22.10.2021 e gjerë me dt. 11.03.2022 dhe nën masën e arrestit shtëpiak nga dt. 11.03.2022 e gjerë me dt. 11.05.2022, ndërsa tani gjendet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Për shkak së:

I. Me datë 22.10.2021, rreth orës 10.01min në fshatin S., K Istog, ka mbajtur në pronësi armë e municion në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit për armë në fuqi, në atë mënyrë që pasi shtien me armë në drejtim të B. M. nga V., me rastin e arrestimit të të njëjtit, policia në ulëset e pasme të veturës së tij G. II gjejnë dhe sekuestrojnë armën- pushkë automatike AK -, e kal ...

mm, me nr.serik, një fishek të kalibrit të njëjtë, një karikator dhe një brisk, për të cilën armë konstatohet se nuk ka leje nga organet kompetente

- me çka ka kryer veprë penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par. 1 të KPRK-ës

II. Më parë e gjer më datë 22.10.2021, rreth orës 10.01min në fshatin S., K Istog, në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në shkallë esenciale i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarës A. F., përndryshe bashkëshortes së tij, në atë mënyrë që pasi të njëjtën e detyron të hyjë në veturë me te G. 2, nën kërcnim se do ta vras dhe merr me vete armën K. AK -.., të cilën e vendosë në ulëset e pasme të veturë, me pretendime se po e tradhton me burrin e motrës së saj B. M. nga V. K Istog të cilin e takon në përballkalim në fshatin S., pasi shte me armë në drejtim të të njëjtit, kthehet në veturë dhe fillon ta godas me grushta në fytyrë duke fyer e ofenduar me fjalët ‘ *se ti je kurvë, nëqoftëse më merr policia herdo kurdo si të dal prej burgut do të mbys* ‘ derisa policia arrinë ta ndal të njëjtin dhe arrestoj, me çrast të njëjtës i shkakton lëndime të lehta trupore kryesisht në regjionin e fytyrës.

- me çka ka kryer veprë penale – **Lëndim i lehtë trupor**, nga neni 185 par. 3, e lidhur me par. 3.1, lidhur me nenin 18 të KPRK-së

Ashtu që gjykata të njëjtin në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 4, 7 8, 9, 10, 18, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 185 dhe 366 të KPRK-së, dhe të nenit 242, 322, 364, 365 të KPPRK-së e:

G J Y K O N

- I. Për veprën penale nga pika I, me dënim me gjobë në shumë prej një mije (1.000.00) euro, e të cilën gjobë i njëjti ka për tu paguar në afat prej nëntëdhjete (90) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Për veprën penale nga pika II, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, e i cili dënim fare nuk ka për tu ekzekutuar nëse i njëjti në afat prej një (1) viti nuk kryen veprë tjetër penale. Në dënimin e shqiptuar konform nenit 79 par. 1, të KPRK-do t’i llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga dt. 22.10.2021 e gjerë me dt. 11.05.2022.
- III. Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) Euro të përcaktuar si në piken I, i njëjti do ti zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur për një ditë burgimi shumë prej 20 (njëzet) euro.
- IV. Nëse i pandehuri, gjatë periudhës së verifikimit si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, kryen veprë tjetër penale, ky dënim do të revokohet dhe do të zëvendësohet me burgim efektiv.
- V. I pandehuri obligohet në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor në shumën e përgjithshme prej dyzet (40) euro, si dhe shumë prej pesëdhjete (50) euro, për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- VI. E dëmtuara A. F. udhëzohet ne kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës eventuale pasurore juridike.
- VII. Në kuptim të nenit 366 par. 3, të KPRK-së, ndaj të pandehurit S. F. i shqiptohet:

DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI

Konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së, të KONFISKOHET arma e municioni dhe atë:

1. Pushka automatike e tipit “AK-.” më nr. serik,
2. Një Karikator i kësaj arme me pesëmbëdhjetë (15) copë fishek të kal. ... mm.,
3. një (1) gëzhgjë e kal. 7.62 mm,
4. një (1) kondak druri si dhe
5. një (1) brisk,

dhe për të cilat **URDHËROHET SHKATËRRIMI** i tyre, pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, duke u thirrur nen numrin e rastit policor të DRP – sipas numrit rastit ...-DF-..., dt. 23.10.2021.

Gjykata duke u bazuar në nenin 83, paragraf 1 dhe 2, nenin 84 paragraf. 1 nën paragraf 1.1 nenin 85 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe neneve 513, 514 nën paragraf 3.1, 3.2, 3.3 të Kodit të Procedurës Penale, të akuzuarit krahas dënimit të shqiptuar si më lartë, i shqipton edhe:

MASËN E TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PSIKIATRIK NE LIRI

1. **MASËN E TRAJTIMIT DETYRUESHËM PSIKIATRIK NË LIRI, pranë Qendrës se shëndetit mendor në Pejë, në kohëzgjatje jo ma shumë se tri vite, e cila do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**
2. **Reparti i Qendrës se shëndetit mendor në Pejë, obligohet që të pranoje dhe trajtoje në pikëpamje psikiatrike të pandehurin S. F., duke udhëzuar për periudhat e sakta në të cilat duhet të paraqitet në trajtim.**
3. **Masa e Trajtimit të Detyrueshëm Psikiatrik në Liri, mund të ndërpritet sipas propozimit te ekspertit.**

Në kuptim të nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPPRK-së, i pandehuri S. F.

LIROHET NGA AKUZA

Gjëja së:

Me datë 22.10.2021, rreth orës 10.01min në fshatin S., K Istog, në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në shkallë esenciale, ka tentuar ta privoj nga jeta personin tjetër për motive të ulëta, në atë mënyrë që me pretendimin se bashkëshortja A. F. po e tradhtonte me burrin e motrës së saj, këtu të dëmtuarin B. M. nga V., K Istog, e merr pushkën automatike AK -..., e kal ...mm të cilën e vendos në ulëset e pasme të automjetit të tij G..II dhe pasi e detyron A. që të hyj në veturën në fjalë me te, e kërkon të dëmtuarin në shtëpinë e tij, meqë të dëmtuarin nuk e gjejnë aty, të njëjtin

e takojnë rrugës në drejtim të B. në përball kalim me kamionetën e K. it meqë ishte në detyrë, pasi i jap shenjë të njëjtit që të ndaloj e pasi del vet nga vetura, i ofrohet të dëmtuarit i cili po qëndronte në kamionetë dhe i drejtohet me fjalë ' *ty jomë tuj t'lypë me ta q... nanën* ', pastaj kthehet tek vetura e tij, me çrast kur i dëmtuari vëren se i njëjti e ka nga dera e pasme e veturës ka nxjerr armën, i ka dhënë automjetit të tij me shpejtësi për tu larguar, gjersa i pandehuri shtien dy herë me pushkën automatike në drejtim të tij,

- Me çka kishte për të kryer veprën penale "Vrasje e rëndë e mbetur në tentative" nga neni 173 par. 1 nën par. 1.8 e lidhur me nenin 28 dhe 18 të KPRK-së

Pasi që nuk është vërtetuar së ka kryer veprën penale në fjale.

Shpenzimet e procedurës penale në raport me këtë pike të aktgjykimit bien në barrë të mjeteve buxhetore.

I dëmtuari B. M. për realizimin e kërkesës eventuale pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

1. Historiku i çështjes

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Krimeve të Rënda me dt. 24.02.2022 ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/I Nr. 220/2021, kundër të pandehurit S. F. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprat penale, "Vrasje e rëndë e mbetur në tentative" nga neni 173 par. 1 nën par. 1.8 lidhur me nenin 28 dhe 18 të KPRK-së, "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve" nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe "Lëndim i lehte trupor" nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 1 nën par 1.1 dhe lidhur me nenin 18 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti i Krimeve të Rënda me dt. 26.10.2022, ka marrë Aktgjykim nën shenjen PKR Nr. 39/22, me të cilin të pandehurin S. F. e ka shpallur fajtor për veprat penale, "Kanosje" nga neni 181 par. 4 e lidhur me par. 1, të KPRK-së, "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve" nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe "Lëndim i lehte trupor" nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 1 nën par 1.1 dhe lidhur me nenin 18 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit në Prishtinë, me dt. 19.01.2023, me Aktvendimin nën shenjen PAKR Nr. 635/2022 ka prishur Aktgjykimin e Gjykatës së shkalles së parë nën shenjen PKR Nr. 39/22 dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje, për arsyet e cekura si në atë Aktvendim.

Gjykata Themelore në Pejë, pas pranimit të lëndës së kthyer në rigjykim, ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor gjyqësor, në të cilën kanë qenë prezentë Prokurori i Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë, i pandehuri S. F., mbrojtësi i tij av. Muhamet Ibraj i angazhuar sipas autorizimit, e dëmtuara A. F. si dhe i dëmtuari B. M.. Seancat e rigjykimit janë mbajtur me dt. 13.04.2023 dhe 15.05.2023.

2. Rrjedhja e procedurës në rishqyrtimin gjyqësor

Gjykata ka mbajtur seancën e rishqyrtimit gjyqësor me dt. 13.04.2023. Në këtë seancë kanë qenë prezentë Prokurori i Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë, i pandehuri S. F., mbrojtësi i tij av. Muhamet Ibraj i angazhuar sipas autorizimit, e dëmtuara A. F. si dhe i dëmtuari B. M..

Në këtë seancë, të pandehurit S. F. prapë i janë komunikuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij ligjore që i takojnë në procedurën penale sipas KPP-së.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, i dëmtuari B. M. ka deklaruar së nuk ka kërkesë pasurore juridike dhe se të njëjtën nuk e parashtron. Po ashtu, e dëmtuara A. F. ka deklaruar së nuk ka kërkesën pasurore juridike dhe së të njëjtën nuk e parashtron.

Gjykata pas kësaj fillimisht ka ftuar Prokurorin e Shtetit që të reflektoje në lidhje me vërejtjet e potencuara nga Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj, dhe të cilat ka kërkuar që të eliminohen, pasi që sa i përket dispozitivit nr. III të aktakuzës, ne aktakuzën e paraqitur nga Prokuroria ka munguar kualifikimi juridik i veprës penale, ashtu që Prokurorja e Shtetit ka deklaruar së në rastin konkret bëhet fjalë për në gabim teknik, se dispozitivi i III-të ka mbetur pa kualifikim juridik të veprës penale, dhe me këtë rast ka bërë edhe plotësimin duke e kualifikuar veprën penale si “Lëndim i lehte trupor” nga neni 185 par. 3 e lidhur me nën par. 3.1 dhe nenin 18 të KPRK-së, kurse pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

Pas kësaj, e meqenëse palët në procedure kanë deklaruar së nuk kanë nevojë që aktakuza të lexohet, dhe kanë hequr dore nga leximi i saj, gjykata ka konstatuar aktakuzën si e lexuar, dhe të pandehurit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet në lidhje me aktakuzën dhe veprat penale për të cilat e ngarkon aktakuza, duke e njoftuar fillimisht me kushtet, privilegjet, pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë.

I pandehuri S. F. me rastin e deklarimit për fajësinë apo pafajësinë ka deklaruar së *nuk e pranon fajësinë për veprën penale nga pika I të aktakuzës, respektivisht për veprën penale “Vrasje e rëndë e mbetur në tentative”, ndërsa për veprat penale nga pika II dhe III të aktakuzës, respektivisht për veprat penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe “Lëndim i lehte trupor” nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 3.1 dhe me nenin 18 të KPRK-së, pranon fajësinë për këto vepra penale, dhe shpreh keqardhje për atë që ka ndodhur.*

Në lidhje me pranimin e fajësisë për pikat II dhe III të aktakuzës, gjykata ka marrë edhe mendimin e palëve në procedure,

Prokurorja e Shtetit ka deklaruar së pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për pikat II dhe III të aktakuzës, meqenëse i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, së pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në shkresat e lëndës dhe i ka propozuar gjykatës që ky pranim i fajësisë të aprovohet.

Mbrojtësi i viktimave nga ZMNV – Pejë ka deklaruar së pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Po ashtu edhe e dëmtuara në raport me piken III të aktakuzës, A. F., ka deklaruar së pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av. Muhamet Ibraj ka deklaruar së me të mbrojturin e tij paraprakisht janë konsultuar, i njëjti vullnetarisht ka pranuar fajësinë për veprat penale nga pika II dhe III të aktakuzës, dhe së pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tij për këto dy pika të aktakuzës.

Në lidhje me këtë, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit S. F. në raport me pikat II dhe III të aktakuzës, si dhe deklarimet e palëve në procedure, dhe në kuptim të nënti 322 e lidhur me nenin 242 par. 1 dhe 2 pika 2.1 e gjer në piken 2.4 të KPPRK-së, ka vlerësuar së i akuzuari kupton pasojat e pranimin të fajësisë, së ky pranim i fajësisë është deklaruar në mënyrë vullnetare, pa ndikim apo ndërhyrje dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në shkresat e lëndës, siç janë *Raporti për gjendjen e shëndetit mendor për të pandehurin S. F. i dt. 24.12.2021 nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, Raporti i Ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë më nr. ref. AKF/....-.../2021-... i dt. 15.12.2021, Akt ekspertimi mjeko-ligjor i Dr..A. G. i dt. 19.01.2022, Raporti i oficerit F. H. i dt. 22.10.2021, Raporti i oficerit B. A. j i dt. 22.10.2021, Raporti i oficerit R. A. i dt. 22.10.2021, Deklarata e të pandehurit S. F. dhënë në polici më dt. 22.11.2021 si dhe ajo e dhënë në këtë prokurori më dt. 18.11.2021, Deklarata e të dëmtuarit B. M. dhënë në polici më dt. 22.10.2021, si dhe ajo e dhënë në këtë prokurori më dt. 18.11.2021, Deklarata e të dëmtuarës A. F. dhënë në polici më dt. 22.10.2021 si dhe ajo e dhënë në këtë prokurori më dt. 26.10.2021, Raporti i Emergjencës së QKMF-së në Istog me nr. DM 0102 i dt. 22.10.2021, Vërtetimi për sekuestrim të përkohshëm të sendeve me nr. të rastit ...-DF-... i dt. 22.10.2021, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njësia e Forenzikës të DRP Pejë, nr. KTI ./... i dt. 22.10.2021, së bashku me fotoalbum të vendit të ngjarjes, kartela e viktimës, alkool testi për të dyshuarin, informacionet e të dyshuarit për të kaluarën kriminale si dhe shkresat tjera të lëndës, foto-dokumentacioni, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, dhe për këtë ka marrë Aktvendim me të cilin është aprovuar pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit për veprat penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe “Lëndim i lehte trupor” nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 3.1 dhe me nenin 18 të KPRK-së, ndërsa fjala përfundimtare është shtyrë deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.*

Pas kësaj, gjykata ka vazhduar seancën e rigjyqimit vetëm në raport me pikën I të aktakuzës, për veprën penale “Vrasje e rëndë e mbetur në tentative” nga neni 173 par. 1 nën par. 1.8 e lidhur me nenin 28 dhe 18 të KPRK-së, dhe atë fillimisht me fjalën hyrëse të palëve në procedure.

2.1.Fjala hyrëse

Prokurorja e Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë në fjalën hyrëse ka deklaruar së: *është e bindur që gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor do të vërtetohet në tërësi se këtu i pandehuri ka kryer veprën penale të përshkruar si në piklën I të aktit akuzues, duke shtuar së mbetet në tërësi pranë fjalës hyrëse me shkrim të dt. 27.07.2022 ku edhe janë listuar provat mbi bazën e të cilave do të provohet se këtu i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, dhe atë në gjendjen e aftësisë së zvogëluar mendore në shkallën esenciale.*

Mbrojtësi i viktimave nga ZMNV – Pejë në fjalën hyrëse ka deklaruar së: *pajtohet në tërësi me fjalën hyrëse të Prokurorit të shtetit.*

I dëmtuari B. M. në fjalën hyrëse ka deklaruar së: *mbetet pranë fjalës hyrëse, përkatësisht deklaratave të dhëna pranë kësaj gjykatë në shqyrtimin e mëparshëm.*

Mbrojtësi i të pandehurit S. F., av. Muhamet Ibraj në fjalën hyrëse ka deklaruar së: *pas shqyrtimit fillestar kemi kundërshtuar kualifikimin sa i përket pikës I të aktakuzës për shkak së prokuroria*

nuk ka mundur të ofroje asnjë provë të vetme në të cilën do të mund të mbështeten pretendimet e saj për piken I të aktakuzës, dhe se pranë kësaj gjykatës janë dëgjuar dëshmitaret dhe të dëmtuarit, dhe në deklaratat e tyre të gjithë kanë mohuar pretendimet e prokurorisë për piken I, si dhe nga provat e marrura në vendin e ngjarjes, nga arma, nga fishekët e konfiskuar në karikator, nga ekzaminimi i automjetet, të cilin nuk ka asnjë shenjë do të vërtetohet qarte së i mbrojturi i tij nuk e ka kryer veprën penale nga pika I të aktakuzës.

I akuzuari S. F. në fjalën hyrëse ka deklaruar së: *e mbështet në tërësi deklarinimin e mbrojtësit të tij, nuk ka çka të shtoj më shumë.*

2.2.Procedura e administrimit të provave

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor gjyqësor të mbajtur me dt. 13.04.2023, gjykata me propozimin e Prokurorit, e me pëlqimin edhe të palëve të tjera në procedure, e në kuptim të nenit 307 të KPPRK-së, ka lexuar provat materiale – personale si dhe ato formale, të administruara gjatë gjykimit të parë. Janë administruar provat më sa vijon: *Deklarata e të dëmtuarit B. M. e dhënë në gjykatë 27.07.2022; deklarata e dëshmitares A. F. në raport me piken I të aktakuzës, të dt. 27.07.2022; deklarimi i ekspertës V. B. R. të dhënë me dt. 27.07.2022; Raporti për gjendjen e shëndetit mendor për të pandehurin S. F. i dt. 24.12.2021 nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, Raporti i Ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë më nr. ref. AKF/....-.../2021-.... i dt. 15.12.2021; Akt ekspertimi mjeko-ligjor i Dr. A. G. i dt. 19.01.2022; Raporti i oficerit F. H. i dt. 22.10.2021; Raporti i oficerit B. A. i dt. 22.10.2021; Raporti i oficerit R. A. i dt. 22.10.2021; Deklarata e të pandehurit S. F. e dhënë në polici më dt. 22.10.2021 si dhe ajo e dhënë në prokurori më dt. 18.11.2021; Deklarata e të dëmtuarit B. M. dhënë në polici me dt. 22.10.2021, si dhe ajo e dhënë në prokurori më dt. 18.11.2021; Deklarata e të dëmtuarës A. F. dhënë në polici më dt. 22.10.2021 si dhe ajo e dhënë në prokurori më dt. 26.10.2021; Raporti i Emergjencës së QKMF-së në Istog me nr. DM ... i dt. 22.10.2021; Vërtetimi për sekuestrim të përkohshëm të sendeve me nr. të rastit-DF-... i dt. 22.10.2021; Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Njësia e Forenzikës të DRP Pejë, nr. KTI ../104 i dt. 22.10.2021, së bashku me fotoalbum të vendit të ngjarjes; alkool testi për të dyshuarin S. F.; informacionet e të dyshuarit për të kaluarën kriminale si dhe shkresat tjera të lëndës; foto-dokumentacioni.*

2.3.Përshkrimi i provave personale

Gjykata me pëlqimin e të gjitha palëve në procedure ka lexuar deklaratën e ekspertës së psikiatrisë **V. B. R.**, e cila në seancën e shqyrtimit kryesor të dt. 27.07.2022, ka deklaruar se: mbetet në tërësi pranë ekspertizës së dt. 24.12.2021, e cila është realizuar në mënyre hospitalore pranë IPFK. E njëjta ka sqaruar se gjatë vlerësimit psikiatrik të S. F., janë marr për baze gjendja klinike e paraqitur nga ana e tij, të dhënat anamnestike apo nga vet S, janë analizuar të gjitha shkresat e lëndës të siguruara nga Prokuroria, të dhënat heteroanamnestike, konkretisht nga bashkëshortja e tij, po ashtu janë realizuar analizat laboratorike si dhe ekzaminimet diagnostikuese, EEG, TK e kokës, rezonanca magnetike të kokës, dhe pas të gjitha këtyre kemi ardhur ne përfundim apo ne konkludim se, S. F., vuan nga çrregullimi mendor i quajtur: Çrregullim deluzional, i cili sipas klasifikimit ndërkombëtar kodohet me shifrën F22, karakteristika e këtij çrregullimi është ideja e gabuar edhe përkundër realitetit dhe provave me të cilat ne kushte normalë do të hudhni poshtë këtë ide, apo edhe nga një grup idesh ku të cilat janë të lidhura njëra me tjetrën. Fillon diku pas moshës 30 vjeçare individi munde te funksionojë pa problemë ne të gjitha sferat e jetës përveç asaj sfere u është i përfshire deluzioni. Po ashtu, sipas auto të dhënave (nga vet pacienti), hetero të dhënave (nga bashkëshortja) dhe nga pasqyra klinike, e prezantuar gjatë qëndrimit ne IPFK te personit S. F., është konstatuar edhe Çrregullimi

mendor, si pasoje e përdorimit të alkoolit i cili kodohet me shifër F10, e po ashtu ne rezonancën e magnetikë të kokës të dt. 13.12.2021, është konstatuar atrofi kortikale supra tendoriale, që nuk i përgjigjet moshës e pacientit e realizuar ne kliniken e radiologjisë. Në lidhje me këto diagnoza, ekspertja po ashtu ka deklaruar se këto dy diagnoza janë të veçanta dhe të pavarura nga njëra tjetrën pasi që çrregullimi deluzional, mund të përfshije edhe personat tjerë, të cilët nuk konsumojnë alkoolin mirëpo edhe të alkooli mund të shfaqen simptomat e xhelozisë nga përdorimi i alkoolit, e që ne rastin konkret ka pas edhe me herët ide deluzive të xhelozisë. Se a mundet përdorimi i alkoolit ta përkeqësoje këtë sëmundje, e njëjta shton se, përdorimi i alkoolit ka mundur dukshëm të ndikojë ne atrofi (mosushqyeshmeri) e korteksit trunor sidomos ne këtë moshe apo ne moshat e hershem e që nuk i përgjigjet moshës, pra shkaktar kryesor është përdorimi i shtuar i alkoolit ne sasi me të mdhaja. Ndërsa sa i përket çrregullimit deluzional përdorimi i alkoolit mundet të përforcoje idetë deluzive. Në lidhje me trajtimin ka sqaruar se këta persona duhet të trajtohen dhe trajtimi për me qene sa ma i suksesshëm duhet të filloje ne fazat se me të hershme, sepse me vone krijohet kapsullimi i ideve, atëherë nevojitet terapi edhe me doza me të larta dhe permanentë dhe se ne qoftë se trajtohen me rregull dhe sipas indikacioneve të mjekut, atëherë rreziku zbehet, mirëpo duhet të jete dikush prezent që e monitoron ne mënyrë që të përcjellët se a merret terapia me rregull. Po ashtu shton se personi duhet te këtë dikën që e monitoron dhe duhet ta merr terapinë çdo ditë. Mirëpo te rasti konkret, kemi të bëjmë me atrofi e cila është lëmi e neurologjisë dhe e përfshinë mjekun neurolog e qe trajtimi duhet të jete prioritet aktualisht meqenëse kemi te bëjmë me një sëmundje progresive dhe e cila e dëmton njohjen e individit (vëmendjen, përqendrimin, të menduarit, kujtesën, emocionet) do të thotë ky është prioritet fillimisht mandej mund të vazhdohet me pjesën e sjelljes dhe emocionale. Në lidhje me ndryshimet trunore tek të pandehuri e njëjta shpjegoi se këto ndryshime kanë të bëjnë me njohje, kujtese, vëmendje, te menduar, përqendrimet, dhe qelizat trunore nuk rigjenerohen edhe përkundër marrjes se terapisë por terapia adekuate mund të ndikohet që ky progresion të jete sa ma i ngadalshëm. Sa i përket sjelljes së të pandehurit e njëjta deklaroi se gjate qëndrimit ne IPFK, sjellja e tij, ka qenë shume korrekte dhe ne asnjë momente nuk ka pas nevojë për ndonjë intervenim shtese, po ashtu nuk ka pas asnjë sinjal për ndonjë rrezik të shfaqur nga ana e tij, por ne rastet e tilla ne përgjithësi nuk priten rreziqe apo rrezikimi i personave të tjerë, apo te personave të cilat nuk janë përfshi ne këtë ide apo ne deluzion andaj sjellja e tij ka qenë konform situatës, ka pas nevojë për trajtim dhe ka qene i domosdoshëm shume vite me herët por që duke marre për baze që funksionojnë ne të gjitha sfera përveç ku është përfshire ideja e deluzionit këto persona nuk vërehen nga të tjerët dhe për këtë arsye nuk ndërmerret ndonjë iniciativë nga të tjerët. Zakonisht këto persona nuk pranojnë që kane problemë edhe pos po qe se te tjerët mund t'ju thonë dhe trajtimi i tyre fillon ne shumicën e rasteve pas ndonjë vepre e zakonisht fillohet nga autoritetet, nga policia, gjykata, burgu etj. Kështu që po të ishte trajtuar me herët deluzionet, do të ishin zbehur edhe veprimet e tij, e tilla nuk kishin pasur vend sepse personi kishte fillua me kuptua realitetin e jo me jetua ne bindje të gabuar. Trajtimi është afatgjate dhe mund të jetë gjatë gjithë jetës. Në lidhje me aftësinë e tij të zvogëluar në shkallë esenciale ne momentin e kryerjes së veprës penale e njëjta deklaroi se ne aspektin psikiatrik llogaritshmëria apo aftësia mendore ka të beje me gjendjen e vetëdijes se individit para gjate dhe pas veprës. Personi ka qene me vetëdije të ngushtuar por jo plotësisht e larguar pasi që veprimet e tij, nuk kane qene te pavetëdijshme por prezenca e deluzionit, konsumimi i alkoolit, e po ashtu edhe gjendja atrofike e trurit kane ndikuar ne zvogëlimin e aftësisë mendore për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e tij ne shkallë esenciale e po ashtu edhe ne parashikim të pasojave. I njëjti është i aftë të marrë pjese në gjykim.

Po ashtu, gjykata me pëlqimin e palëve ka lexuar edhe deklaratën e të dëmtuarit – dëshmitarit **B. M.** të dhënë në seancën e dt. 27.07.2022, i cili ndër të tjera ka deklaruar se: ka dhënë deklaratën në lidhje me rastin ditën kritike në polici, si dhe më pas në prokurori, këto deklarata janë të

vërteta dhe se qëndron pranë atyre deklaratave. Të pandehurin S. F., e njeh 15-16 vite dhe me të është në raport miqësie pasi që bashkëshortët e tyre janë motrat. Sa i përket raporteve, deklaroi se në fillim kanë qenë të mira ndërsa pastaj janë përkeqësuar dhe se nuk flasin që 15 vite, ndërsa arsyeja është sepse i njëjti është xheloz në gruan e tij. Në lidhje me ditën kritike me dt. 22.10.2021, i njëjti ka deklaruar se ka qene ne pune, ne pune ka shkuar ne mëngjes para orës 7:00, punon ne KEDS, aktualisht ne G. e ka bazën, ka qene një shtylle e dëmtuar dhe ka shkuar me rregullua me kamion, me koleget e tij. Ne atë mëngjes ka ardhur edhe vëllai prej S. por të njëjtin nuk ka pa, i njëjti për të parë ka ardhë të shkolla ne B. dhe tani është kthyer ne shtëpi, rreth orës 10 të ditës jemi takuar, dhe kur ka shkuar ne shtëpi e ka thirr ne telefon ne vajber, i ka thënë se po te kërkon dikush te shtëpia, tha kush është, me tha se është S.me A.i kam thënë thuaj se motrën e ka ne Prishtinë ne terapi se është me kancer, nuk është ne shtëpi, vëllai me ka thënë gjoja se S. ka ardhë diçka për rryme me bisedua dhe po donë me taku me mu, ashtu me ka thënë vëllai. Unë i kam thënë se jam të shkolla ne Banjë, le të vijne për të biseduar. Kam qene ne korpe ne lartësi, kolegeve ju kam thënë me leshu korpen, kam zbritur nga korpa, kam marr xhipin e KEDS-it dhe kam shku të shkolla e B., dhe kam pritur 2 minuta, pastaj kam nisur ne drejtim të Vrelles, kam shkua të shtëpia e ime, nuk kam hyre brenda, kerri i tij nuk ka qenë aty, e kam thirr djalin sepse punon me rrym dhe ishte ne fshat, i kam thënë shko te shpija se ka ardhë S.me A., ai nuk qenka aty unë u ktheva dhe shkova ne S. ne drejtim të Banjës me mendjen që e thirra djalin dhe a mos ka ndonjë problem, jam kthyer ne S. për ne shtëpi, duke vazhduar ne drejtim te shtëpisë, pa kaluar një kilometër gjatësi e kam vërejtur kerrin e S., unë jam ndalur ne krahun e djathtë, ishim ne përball kalim, kam qel xhamin e veturës, ai është ndalur ne anën e majte, ai me paren fjale me ka sha me nënën, ai ka qenë ne kerr, që të dyte kishim dritaret e hapura, unë nuk i kam thënë asnjë fjale. Me ka thënë me fjalët “ty jam duke të lyp me ta q. atë nënë” unë menjëherë kur e ka thënë atë fjale ja kam nis, ne nisje e sipër me automjetin e tij, ai ka dal prej kerrit, ka qel derën e pasme të kerrit, dhe distanca mes meje dhe atij kur e kam pa ne pasqyre ka qene rreth diku 20 metra. Ka nxjerr diçka të gjatë prej kerrit, dhe kam mujtur me vërejt që është ne lëvizje S. dhe kam dëgjuar krismën. Në momentin kur ka pa armen i njëjti deklaroi se ka tentuar të largohet sa më shumë dhe ka dëgjuar krismën. Ka deklaruar se i pandehuri e ka kërkuar tek shtëpia e tij dy here dhe se para derës ka gjetur disa shishe te thyer të birrës. I njëjti në lidhje me momentin kritik kur i pandehuri ka nxjerrë armen nga vetura shpjegon se ai kur ka filluar mu kthy siç e sqarova ne drejtimin tim, unë jam largu, kam ikur dhe skam muajt me pa, veç sa kam muajt mi jep automjetit dhe nuk e kam pa por krismat e kam dëgjua dhe atë sqaron, se si e kam pa tu kthy ne drejtimin tim e kam ikur dhe nuk kam pa dhe shton se ne momentin kur ky e ka nxjerrë mjetin nga vetura, dhe kur është nisur me drejtua ka unë, unë nuk e kam përcjellë në pasqyre sepse jam frikësuar, ndërsa distanca ne këtë moment ka qene diku rreth 150 metra. I njëjti tutje deklaroi se ka dëgjuar dy krisma, ndërsa në momentin e krismave të armës nuk ka mundur të vërej se a ka qene arma e drejtuar në drejtimin e tij, dhe po ashtu nuk ka vërejtur ndonjë dëmtim eventual të predhave në veturën e tij. Po ashtu I njëjti sqaron se Unë nuk kam pa që me ka gjuajtur drejt, ne momentin kur ka fillua lëvizje nga unë, prej stresit qëllimi im ka qene që të iki, të largona, ashtu siç e përshkrova më lart. Kur kam kaluar 20 metra distance ai ka qene duke dal prej derës e par, e kam vërejtur duke hapur derën e dyte, unë isha ne lëvizje, dhe ne lëvizje e sipër kam vërejtur që ka nxjerr diçka e gjate nga kerri, kam vazhdu unë gaz hala, kam vërejtur personin duke kthyer ne drejtimin tim, atëherë i kam dhënë kerrit sa me shume sa kam muajt me largu dhe pas një kilometër kam thirr policinë. Vendi I ngjarjes është një rruge e drejte rreth 200 metra, tani ka kthesa, dritaren e ka pas të hapur dhe ka dëgjuar vetëm krismën por fishkëllimet jo.

Po ashtu, me pëlqimin e palëve është lexuar edhe deklarata e dëshmitares **A. F.**¹, e cila me dt. 27.07.2022 ka deklaruar se: në lidhje me rastin ka dhënë dy deklarata, një në polici dhe një në Prokurori, sa i përket deklaratës së dhënë në polici nuk i kujtohet pasi që ka qenë e stresuar, ndërsa në Prokurori ka treguar të vërtetën. Të dëmtuarin B. e njeh pasi që është burri i motrës së saj, dhe me të kanë pas raportet e mira ne fillim, mirëpo më vonë janë përkeqësuar sepse ka pas keqkuptime mes familjes se tij dhe familjes se saj dhe burrit të saj. Keqkuptimi ka qenë në lidhje me do SMS ku i dëmtuari ka pasur me taku motrën e saj, ndërsa i pandehuri ka menduar se e ka thirrur atë. Ditën kritike deklaroi se përnjëherë ka ndodh, ditët me herët mirë ka qene, atë ditë u qua dhe ka qenë nervoz, kështu nuk ka qit nervozen por ne pamje dukej i qetë, por ne brendësi ka qene nervoz, ka shkua te qaji, shefi dhe u nervozua me to, i ka thënë një dite përpara shefi lidhur me atë çka i kishte thënë shefi për mu, pastaj kane fol me shefin, unë isha personalisht me S. me shefin, tani jemi kthye ne shtëpi, dhe pas insistimit të tij kemi shkuar te shtëpia e Basrise për të biseduar ne lidhje me telefonatën a është e vërtete a nuk është e vërtete, dhe se ajo ka shkuar me dëshirën e vet për tu sqaruar, ndërsa i pandehuri armen e ka pas në veture mirëpo nuk i ka treguar se pse e mban ne veture. Unë jam hi brenda dhe e kam thirr motrën, nuk ka qene askush, S. ka prit të kerri ne oborr, pastaj S.ka shkuar të shtëpia e vëllait të B. për me pyet se ku është B., S. e ka gjetur vëllain e B. të shtëpia dhe ai e njoftoi se B. është në punë, tani vëllai i B., e thirri B., i tha është ka të thirr ty të shpija, mdoket edhe një here e ka thirr dhe B. ju ka përgjigj se është duke ardhur. E kane kontaktuar edhe nënën e B. për ta marrë numrin e tij të telefonit, dhe pastaj kanë nisur për banjë për të biseduar me B.. ne u nisem për B. edhe u takuam, ky ka ardhë prej B., na kemi qene duke shkuar për B. dhe jemi takuar, ne gjatë rrugës e kemi pa automjetin e tij, u ndalem ne krahun e lëvizjes, ndërsa ky na ka kalu neve dhe është ndal ma poshtë pas përball kalimit që kemi pas mes veti, Sefa e ka thirr dhe i tha hajde me fol, dhe ky, Basria i ka bërë me dore “çka po donë”, tani Sefedini u nervozu dhe ka zbrit nga kerri dhe ka marr automatën që e kishte ne karrigen e mbrapme, dhe ka gjuajt përpjetë. Ne momentin kur ka gjuajt as qe nuk është dok. Këtë S. e ka bërë prej nervozes pasi që ai është largu shpejt. E njëjta deklaroi se i pandehuri ka gjuajtur përpjete dhe jo në drejtim të dëmtuarit. Shton se i dëmtuari dhe i pandehuri nuk kane fol mes veti, ndërsa ajo me motrën e saj po. Për ditën kritike deklaroi se i dëmtuari ka qenë në kerr dhe i pandehuri nuk ka shkuar ne drejtimin e tij, po ashtu nuk i kujtohet a ka përdorur fjale kërcënuese, ndërsa ne momentin kur ka shtënë me arme për distancën nuk e din saktë mirëpo ka qenë larg dhe se i dëmtuari është larguar me shpejtësi.

2.4.Mbrojtja e të pandehurit

I pandehuri S. F., me dt. 15.05.2023 është ftuar për të dhënë mbrojtjen e tij, mirëpo i njëjti edhe përkundër faktit që është deklaruar në gjykimin e parë, në rigjykimin ka deklaruar së dëshiron të shfrytëzon të drejtën e tij që të mbrohet në heshtje, ashtu që gjykata ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve në procedure.

2.5.Fjala përfundimtare

Prokurorja e Shtetit në fjalën përfundimtarë ka deklaruar së: mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë në shqyrtimin e kaluar, me dt. 22.09.2022, të njëjtën e ka dorëzuar me shkrim, dhe po ashtu ka theksuar se nëse i referohemi të gjitha provave materiale dhe personale të administruara në shqyrtim, e në lidhje edhe me aktvendimin e Gjykatës së Apelit, konsideron së përtej çdo dyshimi mirë të bazuar sa është vërtetuar se në rastin konkret në të gjitha veprimet e të pandehurit janë përmbushur elementet e veprës penale me të cilën ngarkohet, respektivisht

¹ Dëshmitarja A. F. në raport me piken I është dëshmitare, ndërsa në raport me piken III është e dëmtuara, mirëpo për piken III i pandehuri ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar.

nga pika I të aktakuzës për veprë penale “Vrasje e rëndë e mbetur në tentativë” nga neni 173 par. 1 nën par. 1.8 e lidhur me nenin 28 dhe 18 të KPRK-së, duke shtuar se prokuroria mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe të gjitha propozimeve si dhe pranë masës së propozuar të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

I dëmtuari B. M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar së mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë në shqyrtimin kryesor të mëparshëm dhe se nuk ka çka të shtojë më shume.

E dëmtuara A. F. në fjalën përfundimtare ka deklaruar së mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë në shqyrtimin kryesor të mëparshëm dhe se nuk ka çka të shtojë më shume.

Mbrothësi i të akuzuarit S. F., av. Muhamet Ibraj në fjalën përfundimtare ka deklaruar së: mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë në gjykimin e mëparshëm, të dt. 22.09.2022, dhe shton edhe një fakt se sa i përket të gjeturave të Gjykatës së Apelit në raport me lartësinë e dënimit me gjobë, kërkon nga gjykata që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimit të ketë parasysh dhe ti shqiptojë një dënim më të butë ngase i pandehuri nuk ka ndonjë marrëdhënie të rregullt punë, dhe është mbajtësi i vetëm i familjes.

I akuzuari S. F. në fjalën përfundimtare ka deklaruar së: mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë në gjykimin e parë me dt. 22.09.2022, po ashtu mbështet në tërësi deklarimin e mbrojtësit tij dhe nuk ka çka të shtojë më shumë.

3. Gjendja e vërtetuar faktike

Andaj, pas mbajtjes dhe përfundimit të rishqyrtimit kryesor gjyqësor, pas parasysh edhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit S. F. për veprat penale nga pika II dhe III të aktakuzës, respektivisht për veprat penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, dhe “Lëndim i lehte trupor” nga neni 185 par 3 lidhur me par 3.1 dhe me nenin 18 të KPRK-së, gjykata ka vlerësuar dhe gjetur së në raport me pikat II dhe III të aktakuzës pa mëdyshje janë vërtetuar të gjitha elementet e veprave penale të cilat prova të pandehurit i vihen në barrë. Kjo vërtetohet me provat e bashkangjitura aktakuzës, e në të cilat është mbështetur edhe pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit S. F..

Mirëpo, sa i përket veprës penale nga pika I të aktakuzës, respektivisht për veprën penale “Vrasje e rëndë e mbetur në tentativë” nga neni 173 par. 1 nën par. 1.8 e lidhur me nenin 28 dhe 18 të KPRK-së, gjykata ka gjetur se me provat e propozuara dhe të administruara, nuk është vërtetuar së i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Mbi këto arsye, gjykata në vazhdim të këtij aktgjykimi do të fokusohet vetëm në veprën penale nga pika I të aktakuzës, për të cilën është zbatuar procedura e provave, ndërsa sa i përket veprave penale nga pika II dhe III, gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

4. Vlerësimi i provave materiale – formale

Gjendja faktike e vërtetuar si më lartë, është vërtetuar dhe argumentuar me faktet, respektivisht provat formale – materiale të cilat u administruar gjatë këtij shqyrtimi kryesor gjyqësor, si në vijim:

- Nga **raporti për gjendjen e shëndetit mendor për të pandehurin S. F.** i dt. 24.12.2021, i punuar në IPFK nga ekipi i eksperteve i përberë nga Dr. V. B. R., psikiatër, Dr. G. H., neuropsikiatër dhe A. V., psikologe, të cilët në akt ekspertimin dhe mendimin e tyre përfundimtar kanë konstatuar se:
Të i ekzaminuari S. F. është konstatuar:
- Çrregullim mendor, i quajtur – Çrregullim deluzional, i cili në klasifikimin ndërkombëtar të sëmundjeve kodohet si F22.0 (ICD-10)
 - Çrregullim mendor si pasoje e përdorimit të alkoolit, i cili në klasifikimin ndërkombëtar të sëmundjeve kodohet si F10 (ICD-10)
 - Atrofi kortikale supratentoriale, që nuk i përgjigjet moshës së pacientit.
- Karakteristike e çrregullimit deluzional është një ide e vetme deluzive (bindje e gabuar) apo një grup i ideve deluzive të cilat janë lidhura mes veti, janë të vazhdueshme dhe ndonjëherë mund të zgjasin gjatë gjithë jetës. Simptomat e tjera psikopatologjike kryesisht mungojnë, mirëpo mund të shfaqen here pas here simptomat depresive. Pra personi mund të funksionin pa problem, përveç në sferat me të cilat janë të ndërlidhura idetë deluzive.
 - Nuk ka histori të trajtimit në aspektin psikiatrik apo psikologjik.
 - Në momentin e kryerjes së veprës për të cilën dyshohet, duke marrë parasysh specifikat e çrregullimit, të kombinuara me përdorimin e alkoolit dhe ndryshimet e shfaqura trunore, aftësia mendore për të gjykuar për veprën si dhe aftësia për kontrollin e veprimeve të tij ka qenë e zvogëluar në shkallë esenciale.

Po ashtu, ekspertet kanë bërë propozimin që për shkak të ndryshimeve trunore, të paraqitura në RM, të trajtohet nga ana e neurologut. Po ashtu, në aspektin psikiatrik i kane propozuar gjykatës masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, në Qendrën e shëndetit mendor në Peje, ndërsa në rast të mosrespektimit të kësaj mase, të trajtohet me ndalim në repartin e psikiatrisë në spitalin rajonal të Pejës, sipas dinamikës së paraparë nga mjeku trajtues.

- Nga **raport i ekspertimit nga AKF** me nr. ref. AKF/....-..../2021-.... dt. 15.12.2021 vërtetohet se dëshmia e evidentuar me shifër 1, është një (1) gëzhoje, pjese e fishekut të kalibrit 7. mm. ajo është qiturore nga pushka automatike e dëshmisë 2. Ndërsa, dëshmitë të evidentuara me shifra 2 dhe 4 janë një pushke automatike ASH-..., tip 1, e kalibrit 7. mm, version i pushkës automatike AK-..., me numër serik, e cila është funksionale, dhe një karikator i zbrazur me kapacitet prej tridhjetë fishekëve të kalibrit 7...mm i dizajnuar për pushkën AK-..apo versionet e saja
- Nga **raporti i oficerit Fadil Hoxhaj** dt. 22.10.2021 vërtetohet se me dt. 22.10.2021, policia është informuar se në afërsi të fsh. V. një person është kërcënuar dhe ka pasur të shtëna me arme zjarri. Me rastin e daljes në vendin e ngjarjes kanë gjetur një gëzhoje të armës që dyshohet të jetë AK-... Po ashtu vërtetohet se është iniciuar rasti si Vrasje në tentative, armëmbajtje pa leje dhe dhune në familje, ndërsa i pandehuri S. F. është ndaluar.
- Nga **raporti i oficerit B. A.** dt. 22.10.2021, vërtetohet se ditën kritike janë njoftuar që të shkojnë të shtëpia e B. M.u ku i njëjti ishte kërcënuar nga dikush. Me të dalur në terren të njëjtit e kane kuptuar nga vëllai i B. M. se ky i fundit ishte sulmuar me arme, në dalje

të fsh. V. në drejtim të Banjës. Pas kësaj kanë dalur në vendin e ngjarjes u ne cepin e djathtë të rrugës e kane gjetur një gëzhoje e armës AK-..., ku e njëjta është mbledhur nga ana e krim teknikut.

- Nga **raporti i oficerit R. A.** dt. 22.10.2021 me të cilin raport vërtetohet se ditën kritike kanë shkuar në shtëpinë e të pandehurit, ky i fundit nuk ka qenë ne shtëpi dhe sipas bashkëshortes së tij kishte dalur me veturën e tij, të njëjtit e kanë bërë bastisjen e shtëpisë dhe kanë gjetur një kondak i drurit të pushkës automatike në shtëpi, po ashtu bashkëshortja e të njëjtit ka njoftuar policinë që ka qene e sulmuar fizikisht nga ana e të pandehurit, dhe se i pandehuri është ndaluar nga ana e njesisë speciale dhe është dërguar në stacionin policor në Istog, ku më të vërejtur se i njëjti ishte nen ndikimin e alkoolit është bërë alkotesti i cili ka rezultuar të jete 1.33 promilë.
- Nga **deklarata e të dëmtuarit B. M.** e dhënë në stacionin policor i njëjti ka shpjeguar se nga vëllai i tij ka kuptuar se i pandehuri e kishte kërkuar në shtëpi, pas kësaj janë takuar në fsh. V. ku i pandehuri ka qenë ne veturën e tij se bashku me bashkëshorten e tij A., dhe me të takuar me të dëmtuarin i njëjti i është drejtuar me fjalët se “ty jam tu të lypë me ta q. atë nënë” dhe ka filluar me qel derën e kerrit të mbrapa, ndërsa i dëmtuari më të vërejtur se diçka nuk është në rregull ka filluar të largohet nga vendi i ngjarjes ku me rastin e largimit ka dëgjuar dy krisma. Shton se nuk ka pas probleme me të pandehurin. I njëjti po ashtu në deklaratën e tij të dhënë në prokurori ka shpjeguar rastin në mënyrë të njëjte, ndërsa ka shtuar se me rastin e largimit nga vendi i ngjarjes nga pasqyra anësore të veturës ka vërejtur se S. ka dale dhe nga dera e pasme të kerrit e ka nxjerr ndonjë arme e gjate dhe ka shtëne dy here në drejtim të tij, mirëpo nuk ka ardhur deri te goditja e veturës dhe as që nuk ka dëgjuar fishkëllimet.
- Nga **deklarata e dëshmitares – të dëmtuarës A. F.** e dhënë në stacionin policor vërtetohet se i pandehuri ditën kritike për shkak të xhelozisë ka shkuar se bashku me të me kërkuar të dëmtuarin B., dhe se tek shtëpia e tij kane kuptuar se është në B., ku edhe kanë nisur për të biseduar me të njëjtin, ku gjatë rrugës të dëmtuarin e kanë takuar në fshatin V., ku i pandehuri më të ndalur veturën menjëherë ka dalur nga automjeti, ka hapur derën e pasme të automjetit dhe ka marrë pushkën automatike ku ka gjuajtur në drejtim të automjetit të dëmtuarit. Po ashtu e njëjta në deklaratën e saj e dhënë në Prokurori ka deklaruar rreth ditës kritike ku ka thënë se fillimisht kanë shkuar te shefi i të pandehurit (burrit të saj) dhe janë sqaruar në lidhje me xhelozinë dhe dyshimet që e kishte i pandehuri, pas kësaj kanë shkuar dhe kanë kërkuar të dëmtuarin B. ne shtëpinë e tij, ku kanë kuptuar se është në B. dhe kane nisur në drejtim të B., ku rrugës në përball kalim e kanë takuar B., i cili është ndal në rrugë dhe e ka pyetur S. se çka u bë, dhe pas kësaj i pandehuri ka dalur nga vetura dhe ka marrë armën nga ulëset e pasme të veturës por deklaroi se ka gjuajtur përpjetë, në ajër. Në lidhje me mospërputhje me atë se çka ka deklaruar në polici e njëjta ka treguar se ditën kur ka dhënë deklaratën ne polici ka qenë e shqetësuar pasi që ka qenë e sulmuar edhe fizikisht nga i pandehuri dhe derisa kane shkuar në V. i ka thënë se kam me të vra ty dhe kam me vra B..
- Nga deklaratat e të pandehurit S. F. të dhëna në Polici me dt. 22.10.2021 rrjedh se i njëjti ka rezultuar i dehur pas matjes së alko-testit dhe nuk është deklaruar, ndërsa në deklaratën e dyte është mbrojtur në heshtje. Mirëpo i njëjti është deklaruar në prokurori ku ndër të tjera ka deklaruar se ditën kritike fillimisht me bashkëshorten e tij ka shkuar në Pejë për tu sqaruar me shefin e tij, sepse ky i fundit i kishte thënë një ditë përpara se “ti boll të mirë e ki gruan” po e mjera gruaja kënd e paska marr”, dhe për këtë punë janë sqaruar

me shefin e tij dhe janë ndarë të pajtuar, pastaj kanë nisur në drejtim të Istogut për të takuar të dëmtuarin B. për me sqarua punën e 15 viteve kur i dëmtuari e ka thirr bashkëshorten e tij në telefon dhe ka lype me dal me to, kur kane shku të shtëpia e tij në fsh.V. aty nuk e kane gjetur, dhe përmes familjareve të tij kane kuptuar se është duke punuar dhe kane shkuar në drejtim të vendit ku i dëmtuari ka qenë duke punuar. Të njëjtin e kane takuar në rrugë me një veturë – xhip, dhe janë ndaluar në rrugë që të dytë, mirëpo kur i pandehuri ka dalur nga vetura, i dëmtuari i ka dhënë gaz dhe është larguar nga aty , ndërsa i pandehuri ka nxjerre kallashin që e kishte ne veturë dhe ka gjuajtur dy here ne ajër. Për armen ka deklaruar se te njëjtën e ka mbajtur me veti kohëve të fundit pasi që brenda një kohe të shkurtër dikush ka shtënë ne drejtim të shtëpisë se tij.

- Nga raporti mjekësor i lëshuar nga QKMF Istog me nr, DM..., vërtetohet se e dëmtuara A. F. ditën kritike me dt. 22.10.2022, është paraqitur aty nen shoqërim të policisë, dhe se e njëjta ju kishte treguar se kishte qenë e rrahur nga bashkëshorti dhe nga rrahja ka rezultuar se ka pësuar lëndime (hematome) afër syrit të majte.
- Nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt. 22.10.2021, me nr. te rastit policor-DF-..., vërtetohet se nga i pandehuri janë sekuestruar përkohësisht sendet dhe atë: një gëzhoje AK-..., një pushke automatike AK-... me nr. serik, 15 fishek të pushkës AK-..., kondak druri, 1 karikator dhe një brisk.
- Nga raporti i këqyrjes se vendit të ngjarjes të dt. 22.10.2021, rrjedh se vendi i ngjarjes kishte qene në rrugë V. – Banjë në fsh. S., në anën e djathtë në rrugë kishte qene një gëzhoje AK-.. kalibër 7.., ndërsa në shtëpinë e të dyshuarit ne sallon nen kauç kishte qene një kondak druri i pushkës automatike, ne veturën e të dyshuarit golf 2, ka qen nen ulësen e pasme një pushke automatike AK-..., me nr. serik, 15 fishek, një karikator dhe një brisk. Arma në fjale ka pas fishekun në tytë, dhe arma kishte qene e bllokuar me siguries.
- Nga **alko-testi** i kryer vërtetohet se i dyshuari S. F., ditën kritike ka qenë nen ndikim të alkoolit, ku pas matjes ka rezultuar që i njëjti ka pasur 1.33 promilë alkooli në gjak.
- Nga foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes, shihet vendi ku ka ndodhur ngjarja ditën kritike (foto 1), shihet gëzhoja kalibër AK-.. (foto 2) , shtëpia e të dyshuarit jashtë dhe brenda (3 dhe 4), kondaku i cili është gjetur në shtëpinë e të dyshuarit (foto 5), po ashtu shihet vetura e të pandehurit dhe vendi ku është gjetur arma, si dhe arma e markës Ak-.. dhe brisku i sekuestruar.

5. *Vlerësimi i provave personale*

Gjykata në seancat e mbajtura të shqyrtimit kryesor në cilësi të dëshmitareve ka dëgjuar ekspertin V. B. R., dëshmitaren A. F., si dhe dëshmitarin të dëmtuarin B. M..

Sa i përket deklaratës së ekspertes **V. B. R.**, e njëjta është deklaruar në lidhje me gjendjen psikofizike e të pandehurit, në lidhje me sëmundjet e tij të cilat janë konstatuar gjatë ekzaminimit të tij në Institutin e psikiatrisë forenzike të Kosovës, ne lidhje me gjendjen e tij ditën kritike, dhe e njëjta ne mënyrë koncize dhe koherente ka shpjeguar të gjitha detajet e sëmundjeve nga të cilat lëngon i pandehuri, ndryshimet e tij trunore, si dhe lidhur me idetë deluzive të cilat shfaqen te ai. Kjo deklaratë e ekspertes është në përputhje të plote me ekspertizën e përpiluar nga ekipi i eksperteve ku pjese e ekipit ka qenë edhe ajo, si ekspertiza, respektivisht raporti mbi gjendjen

mendore e të pandehurit ashtu edhe deklarimi i saj gjatë shqyrtimit kryesor gjyqësor nuk janë kontestuar në asnjë mënyrë nga palët në procedurë, ashtu që gjykata këtij deklarimi i ka falur besimin e plote, duke vlerësuar që është në përputhje të plote edhe me provat tjera personale dhe materiale të cilat janë administruar gjatë këtij shqyrtimi kryesor gjyqësor.

Po ashtu, sa i përket deklaratës së të dëmtuarit – dëshmitarit **B. M.** gjatë shqyrtimit kryesor, i njëjti ka përshkruar ngjarjen kritike në tërësi, duke shpjeguar të gjitha faktet e rëndësishme, duke filluar nga ajo që ditën kritike ka qenë në detyrë duke punuar në fsh. B., dhe se nga vëllai i tij ka kuptuar se i pandehuri se bashku me bashkëshorten ka qenë në shtëpinë e tij, duke e kërkuar, dhe më të kuptuar këtë i njëjti ka marrë veturën dhe ka nisur në drejtim të shtëpisë së tij, ku gjatë rrugës ka takuar të pandehurin dhe bashkëshorten e tij, të cilët po ashtu ishin me veturën e tyre. I njëjti sqaron faktin se i pandehuri ne momentin kur janë takuar i ka thënë së “ty jam duke të lyp me ta q.. atë nënë” ndërsa i dëmtuari menjëherë ka filluar të largohet nga vendi i ngjarjes me veturën e tij, ndërsa në pasqyre ka parë se i pandehuri ka nxjerre diçka të gjatë prej veturës dhe ka dëgjuar krismën. I njëjti i pyetur nga Prokurorja e shtetit në lidhje me dallimet në deklaratat ne shqyrtimin kryesor dhe në prokurori, ka sqaruar se kur e ka vërejtur të pandehurin se ka nxjerrë diçka, që për të ka qenë arma e gjatë, i pandehuri ka filluar të kthehet në drejtimin e tij (në drejtimin ku i njëjti ka qenë duke u larguar nga vendi i ngjarjes), dhe i njëjti po ashtu sqaron se në atë moment kishte qenë larg dhe nuk ka mundur me pa, thekson se “si e kam pa tu kthy në drejtimin tim e kam ikur dhe nuk kam pa më”. Po ashtu i njëjti sqaron se ne momentin kur e ka pa armen, më nuk ka përcjell përmes pasqyrës së veturës veprimet e të pandehurit dhe vetëm ka tentuar të ikë nga vendi i ngjarjes. Në pyetjet e mbrojtësit i njëjti ka pohuar që ka dëgjuar dy krisma, mirëpo ne momentin e krismave të armës nuk ka mundur ta vërej se arma a ka qenë e drejtuar në drejtimin e tij. Po ashtu deklaroi se nuk ka dëgjuar ndonjë fishkëllim edhe pse ka pas te hapur dritaren e veturës, dhe nuk ka pas ndonjë dëmtim eventual të predhave në veturën e tij.

Andaj, ky deklarim i të dëmtuarit – dëshmitarit gjykata e ka gjetur se është në përputhje me provat materiale dhe personale të administruara gjatë këtij shqyrtimi kryesor, e posaçërisht me raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes si dhe me provat tjera, e po ashtu me faktin se a ka pas dëmtime nga predha në veturën e tij. Roli kyç i këtij dëshmitari ka qenë që ta sqaroje lidhur me faktin se në momentin kur i pandehuri ka gjuajtur, a ka gjuajtur në drejtimin e tij ose në ndonjë drejtim tjetër (në ajër, në tokë) mirëpo i njëjti edhe pse në Prokurori ka deklaruar se ka vërejtur të pandehurin duke gjuajtur në drejtimin e tij, një gjë të tillë e sqaroi me faktin se ka vërejtur të njëjtin në pasqyre të veturës duke u kthyer në drejtimin e tij, dhe pas kësaj ka tentuar vetëm ta ikë nga vendi i ngjarjes, kështu që nuk ka mundur të tregojë me siguri të plote se ne cilin drejtim ka shtënë i pandehuri. Si rrjedhojë e kësaj, gjykata një deklarim të tillë të sinqertë ka gjetur së është i besueshëm për vendimmarrje në këtë çështje penale.

Sa i përket dëshmitares **A. F.**, e njëjta në mënyrë pothuajse të njëjte ka shpjeguar lidhur me rrethanat dhe ngjarjet para ngjarjes kritike, respektivisht para takimit të pandehurit dhe të dëmtuarit në fsh. S., mirëpo e njëjta në lidhje me arsyen e takimit ka dhënë deklaratë se “i pandehuri ka dashtë me fol B.”, ndërsa në Prokurori ka deklaruar se i pandehuri i kishte thënë se “do ta vras B. dhe pastaj edhe ty”, po ashtu e njëjta tregon se kur paraprakisht kane shkuar të shefi i të pandehurit për të biseduar, i pandehuri nuk ka pasur armë me veti, ndërsa i pandehuri ka deklaruar se armen ka vendosur në veturë shume kohë përpara. E njëjta po ashtu ka deklaruar se në polici ka qenë e shqetësuar dhe ka kërkuar që kjo deklarate e saj (e dhënë në polici) mos të merret në konsideratë pasi që nuk e din se çka ka deklaruar, mirëpo e njëjta edhe ne Prokurori edhe në këtë shqyrtim kryesor gjyqësor ka deklaruar se i pandehuri ka shtënë me armen e tij në ajër, dhe jo në drejtim të dëmtuarit, ashtu që deklarata këtij deklarimi i ka fal pjesërisht besimin,

dhe atë vetëm sa i përket faktit se në cilin drejtim ka shtënë i pandehuri, sepse është në përputhje edhe me deklarin e të dëmtuarit B..

6. Analiza e fakteve kontestuese dhe jokontestuese

Gjykata pas administrimit të provave personale dhe materiale të lartcekura, ka vlerësuar secilën prove dhe deklarate veç e veç, si dhe në lidhshmëri faktike dhe logjike njëra me tjetrën.

Gjykata fillimisht ka gjetur si fakt jokontestues se ditën kritike, i pandehuri S. F. me bashkëshorten e tij ka shkuar në Pejë, tek shefi i tij, për të sqaruar në lidhje me disa komente që i kishte bërë ky i fundit një ditë përpara. Po ashtu, është fakt jokontestues së pas kësaj bisede, i pandehuri dhe dëshmitarja kane shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit të cilin e kane kërkuar të familjaret e vet, por pasi që i dëmtuari ka qenë në punë, dhe pasi që është njoftuar se e kane kërkuar i pandehuri dhe bashkëshortja e tij, të njëjtit kanë nisur në drejtim të njeri tjetrit dhe janë takuar në fsh. S.. Po ashtu, për gjykatën nuk ka qenë kontestues fakti se a ka pas armen me veti i pandehuri ditën kritike, dhe se ka shtënë me të.

Mirëpo, si fakt kontestues në këtë çështje ka qenë se në cilin drejtim ka shtënë me armë i pandehuri dhe së në veprimet e të pandehurit a qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, si në piken I të dispozitivit të aktakuzës?

7. Gjetjet e gjykatës

Gjykata me asnjë prove të administruar nuk ka mundur ta vërtetoje dyshimin se në cilin drejtim ka shtënë i pandehuri, pasi që nga raporti i këqyrjes se vendit të ngjarjes nuk ka të dhëna se në cilin drejtim ka gjuajtur i pandehuri, pastaj, meqenëse i dëmtuari ka qenë me veturën e tij zyrtare (të kompanisë KEDS), as në atë veture nuk është gjetur dhe nuk është lajmëruar se është gjetur ndonjë prove, dëshmi apo dëmtim nga predhat e armës së zjarrit, e njëjta as që nuk është ekzaminuar, dhe se në rrethinën e vendit të ngjarjes nuk është gjetur ndonjë dëmtim i shkaktuar nga arma e zjarrit, respektivisht ndonjë plumb në ndonjë objekt afër vendit të ngjarjes.

Po ashtu, kjo nuk ka mundur të vërtetohet me siguri të plote as me deklarin e dëshmitareve të këtij rasti, se pari nga i dëmtuari B. M. i cili para gjykatës ka deklaruar se ne momentin kur e ka parë të pandehurin duke nxjerrë armen nga vetura e tij, më nuk ka vëzhguar të njëjtin por vetëm ka tentuar që të largohet nga vendi i ngjarjes sa më shpejte, dhe nuk ka pa në pasqyre momentin kur i pandehuri ka gjuajtur.

Tutje, edhe dëshmitarja A. F. ka deklaruar para gjykatës se i pandehuri ka shtënë në ajër. E njëjta ka deklaruar kështu edhe në polici, dhe po ashtu edhe i pandehuri në deklaratën e tij e dhënë në polici ka deklaruar njësoj.

Gjykata pas këtyre deklarimeve të dëshmitareve, e posaçërisht duke pasur parasysh rrethanën se nuk ekziston asnjë prove të vetme e cila dëshmon pretendimet e dhëna në piken I të aktakuzës, ka ardhur në përfundim së nuk është vërtetuar me bindje të plote dhe përtej çdo dyshimi se i pandehuri ditën kritike ka shtënë me armen në drejtim të të dëmtuarit B. M..

Gjykata në raport me pikat II dhe III të aktgjykimit, respektivisht aktakuzës, duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga i njëjti për këto dy vepra penale, po ashtu edhe me gjitha provat tjera që e mbështesin akuzën, erdhi në përfundim se ne veprimet e të njëjtit formësohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprave penale nga pika II dhe III të aktakuzës.

Pas vlerësimit të pranimit të tij të fajësisë, gjykata ka vlerësuar se i akuzuari ka kryer veprat penale si në piken II dhe III, dhe pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës, e shpalli fajtor si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

8. Konkludimet përfundimtare në raport me piken I të aktakuzës

Andaj, në kuptim të nenit 361 par. 2, të KPPRK-së, gjykata ka vlerësuar me ndërgjegje çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, e në bazë të vlerësimit të tillë, ka gjetur se me asnjë prove bindëse nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar, se, i pandehuri, ka kryer veprën penale për të cilat është akuzuar, nga pika I të aktakuzës.

Kjo për faktin së i pandehuri akuzohet së me datën, vendin dhe kohën e përshkruar si në piken I të diapozitivit të aktakuzës, ka kryer veprën penale “Vrasje e rëndë e mbetur në tentative” nga neni 173 par. 1 nën par. 1.8 e lidhur me nenin 28 dhe 18 të KPRK-së.

Për të vërtetuar këto pretendime, prokuroria ka propozuar, ndërsa gjykata ka administruar provat e propozuara nga Prokuroria e Shtetit. Mirëpo, pas administrimit të këtyre provave, gjykata ka gjetur se me asnjë prove të vetme nuk mund të vërtetohet se i pandehuri ditën kritikë ka ndërmarre veprimet inkriminuese ashtu siç janë përshkruar ne dispozitivin e aktakuzës.

Kjo për faktin së, i njëjti akuzohet së ditën kritike “pasi i jap shenjë të njëjtit që të ndaloj e pasi del vet nga vetura, i ofrohet të dëmtuarit i cili po qëndronte në kamionetë dhe i drejtohet me fjalë’ *ty jomë tuj t’lypë me ta q... nanën*’, pastaj kthehet tek vetura e tij, me ç’rast kur i dëmtuari vëren se i njëjti e ka nga dera e pasme e veturës ka nxjerr armën, i ka dhënë automjetit të tij me shpejtësi për tu larguar, gjersa i pandehuri shtien dy herë me pushkën automatike në drejtim të tij”. Mirëpo, prej këtyre veprimeve inkriminuese për të cilat i njëjti akuzohet, nga provat e administruara, e posaçërisht nga provat personale, e të përshkruara si më lartë, nuk është vërtetuar pretendimi se i pandehuri ka shtënë në drejtim të dëmtuarit. Këtë nuk ka mundur të konfirmojë as i dëmtuari personalisht, i cili ka qenë në një pozite në veturën e tij duke u larguar nga vendi i ngjarjes, ndërsa dëshmitarja A. F. bindshëm ka deklaruar së i njëjti ka shtënë në ajër, ku gjykata në mungesën e provave të tjera nuk pati zgjidhje tjetër përveç t’ia fal besimin deklarimit të të dëmtuarit i cili nuk ka qenë i sigurt dhe nuk ka mundur të konfirmojë drejtimin e të shtënave nga ana e të pandehurit ndërsa e dëmtuara ka deklaruar siç u cek më lartë, dhe për këtë, për gjykatën i vetmi vendim i drejte dhe i duhur ka qenë që të merr aktgjykimin lirues në raport me këtë pike të aktakuzës, dhe atë në mungesën e provave.

Gjykata konsideron së në këtë vend është shume e rëndësishme të theksohet së gjatë gjykimit të parë, pas administrimit të të gjitha provave, ka rezultuar gjendja e njëjte faktike, mirëpo gjykata në raport me këtë pikë të aktakuzës ka gjetur së në veprimet e të pandehurit është realizuar figura e veprës penale “Kanosje” nga neni 181 par. 4 të aktakuzës, dhe të njëjtin e ka shpallur fajtor për këtë vepër penale.

Mirëpo, Gjykata e shkallës së dyte, me rastin e vendosjes lidhur me ankesën e Prokurorit të Shtetit, e po ashtu duke vepruar edhe sipas detyrës zyrtare, ka vlerësuar dhe gjetur së nga përshkrimi i veprimeve inkriminuese për piken I, nuk është realizuar figura e veprës penale të kanosjes, por si të tilla këto veprime materializohen në veprën penale të përdorimit të armës në mënyre kërcënuese apo frikësuese.

Lidhur me këtë, ne seancën e rigjykimit, gjykata e shkallës së parë ka ftuar Prokurorin e Shtetit që të reflektojë në këtë drejtim, lidhur me udhëzimet e Gjykatës të shkallës së dytë, mirëpo përfaqësuesi i akuzës nuk reflektoi dhe nuk veprroi në këtë drejtim, dhe për më tepër, mbeti në tërësi pranë akuzës, kështu që, për ta ruajtur identitetin objektiv të aktakuzës, siç e obligon neni 359 të KPPRK-së, gjykata nuk ka pasur mundësi të veproje ndryshe, pasi që e njëjta e gjykon vetëm ngjarjen nga përshkrimi faktik të dhënë në aktakuze.

Në këtë kontekst, vlen të theksohet së prokuroria nuk ka bërë përpjekje siç e obligon neni 7, të KPPRK-së², në rastin konkret, Prokuroria ka dështuar në detyrën e saj, të ashtuquajturën “barrën e provës” (*onus probandi*), që të mbledhë prova të mjaftueshme dhe bindëse se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilat akuzohet, përderisa, gjykata ka obligim ligjor që të vërtetojë gjendjen faktike mbi bazën e provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesor gjyqësor.

Gjykata po ashtu rikujton një ndër parimet kryesore të procedurës penale “**In dubio pro reo**”, të përcaktuar në nenin 3 par. 2, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës i cili përcakton se, “*Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal, interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij*”, ndërsa interpretimi tjetër në lidhje me këtë parim është së “*në dëm të të pandehurit mund të merret një fakt vetëm atëherë ai kur është vërtetuar pa mëdyshje, kur ekzistimi i tij qëndrojnë jashtë çdo dyshimi*”.

Po ashtu, në këtë drejtim mund të konkludohet se, ky parim është një rregull e përgjithshme dhe e pavarur e procedurës penale. Parimi se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij, aplikohet në procedurën penale me rastin e zgjidhjes së të gjitha fakteve kontestuese, si të atyre që e rëndojnë të pandehurin, ashtu edhe të atyre që i shkojnë në favor. Prandaj, nga kjo del rregulla se të gjitha faktet që shkojnë në dëm të pandehurit, duhet të vërtetohen patjetër me bindje të plotë, por nëse nuk mund të vërtetohen kështu, sepse edhe më tutje mbetet dyshimi për ekzistimin e tyre, merret se ato nuk ekzistojnë. Përkundrazi, për të gjitha faktet që shkojnë në favor të të pandehurit, po qe se paraqiten si të mundshme, e ajo mundeshmëri nuk ka mundur të zëvendësohet me bindje të plotë, duhet të merret patjetër se ekzistojnë.

Po ashtu, paragrafi 2, të nenit 3, të KPPRK-së, gjen aplikimin e vetë edhe me rastin e aktgjykimit lirues, kur nuk është provuar, se, i akuzuari, ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet. Shkaqet humane dhe të drejtësisë, të mbështetura edhe në dispozitat procedurale të sipërpërmendura, na udhëzojnë ndikojnë në formimin e bindjes së tij që, në rast se mbetet dilema për ekzistimin e faktit juridik relevant, duhet të përcaktohet për zgjidhjen që është më e favorshme për të pandehurin, sepse, në rast lajthitjeje, do t’i shkaktojë të pandehurit dëm apo ndonjë padrejtësi më të vogël.

Andaj, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, pas administrimit të provave dhe vlerësimit të të njëjtave, e në bazë të elaborimeve të lartcekura, gjykata ka ardhur në konstatim se nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale, ashtu siç është bërë përshkrimi faktik në dispozitivin I, të aktakuzës, për veprën penale, “Vrasje e rëndë e mbetur në tentative” të KPPRK-së.

² Gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.

Ashtu siç është potencuar më sipër, gjykata aktgjykimin e vet, e mbështet vetëm në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar.

Andaj, mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar, kjo Gjykatë nuk mundi të vërtetojë përtej dyshimit mirë të bazuar se, këtu i pandehuri, ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet. Pretendimet e Prokurorisë nuk u provuan me asnjë prove të vetme, andaj gjykata të njëjtin konform nenit 364 par 1. nën par. 1.3, të KPPRK-së³, e në mungesë të provave, e ka liruar nga akuza dhe për të njëjtin ka marrë aktgjykim lirues.

9. Përgjegjësia penale e të akuzuarit në raport me piken II dhe III të aktakuzës

Në këtë çështje penale, gjykata prej fillimit ka pasur propozim që krahas dënimit të pandehurit t'ia shqiptojë edhe masën e trajtimit të detyrueshëm në liri, pas parasysh të gjeturat e ekipit të eksperteve nga lëmia përkatëse të cilët në aspektin psikiatrik dhe psikologjik kane ekzaminuar të pandehurin në IPFK pranë QKUK në Prishtinë.

Duke shqyrtuar përgjegjësinë e tij penale, gjykata ka marrë për bazë **Raportin për gjendjen e shëndetit mendor për të pandehurin S. F.**, i dt. 24.12.2021, i punuar në IPFK nga ekipi i eksperteve i përberë nga Dr. V. B. R., psikiatër, Dr. G. H., neuropsikiatër dhe A. V., psikologe, të cilët në akt ekspertimin dhe mendimin e tyre përfundimtar kanë konstatuar se:

Të i ekzaminuari S. F. është konstatuar:

- Çrregullim mendor, i quajtur – Çrregullim deluzional, i cili në klasifikimin ndërkombëtar të sëmundjeve kodohet si F..0 (ICD-10)
 - Çrregullim mendor si pasoje e përdorimit të alkoolit, i cili në klasifikimin ndërkombëtar të sëmundjeve kodohet si F. (ICD-10)
 - Atrofi kortikale supratentoriale, që nuk i përgjigjet moshës së pacientit.
-
- Karakteristike e çrregullimit deluzional është një ide e vetme deluzive (bindje e gabuar) apo një grup i ideve deluzive të cilat janë lidhura mes veti, janë të vazhdueshme dhe ndonjëherë mund të zgjasin gjatë gjithë jetës. Simptomat e tjera psikopatologjike kryesisht mungojnë, mirëpo mund të shfaqen here pas here simptomat depresive. Pra personi mund të funksionin pa problem, përveç në sferat me të cilat janë të ndërlidhura idetë deluzive.
 - Nuk ka histori të trajtimit në aspektin psikiatrik apo psikologjik.
 - Në momentin e kryerjes se veprës për të cilën dyshohet, duke marrë parasysh specifikat e çrregullimit, të kombinuara me përdorimin e alkoolit dhe ndryshimet e shfaqura trunore, aftësia mendore për të gjykuar për veprën si dhe aftësia për kontrollin e veprimeve të tij ka qenë e zvogëluar në shkallë esenciale.

Po ashtu, ekspertet kanë bërë propozimin që për shkak të ndryshimeve trunore, të paraqitura ne RM, të trajtohet nga ana e neurologut. Po ashtu, në aspektin psikiatrik i kane propozuar gjykatës masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, në Qendrën e shëndetit mendor në Peje, ndërsa

³ *Gjykata merr aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza nëse: nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet"*

në rast të mosrespektimit të kësaj mase, të trajtohet me ndalim në repartin e psikiatrisë në spitalin rajonal të Pejës, sipas dinamikës së paraparë nga mjeku trajtues.

Andaj, duke u bazuar në këtë ekspertizë të psikiatrisë dhe në të gjeturat e ekipit të eksperteve, gjykata ka ardhur në përfundim se i pandehuri ka qenë në gjendjen e **përgjegjesisë së zvogëluar esencialisht në kohën e kryerjes së veprës penale**, e parashikuar me nenin 18 par. 2 të KPRK-së. Sipas këtij neni, personi që ka kryer veprën penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore, nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar a kontrolluar veprimet a mosveprimet e tij, ka qenë e zvogëluar dukshëm. Tutje, personi i cili vepron në gjendjen e përgjegjesisë së zvogëluar esencialisht në kohën e kryerjes së veprës penale është penalisht përgjegjës, por mund të dënohet më butë.

10. Rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese

Kryetari trupit gjykues në aplikim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri për veprat penale për të cilat është shpall fajtor ka pranuar fajësinë, ka shprehur pendimin e tij për ngjarjet e ndodhura dhe veprat e kryera, ka pasur sjellje korrekte gjatë gjykimit, i njëjti ka qenë i pranishëm në të gjitha seancat ashtu që nuk ka shkaktuar shtyrje të panevojshme të shqyrtimit kryesor, rrethanat psikofizike të cilat kanë ndikuar tek i akuzuari për ta kryer veprat penale në gjendjen e zvogëluar në shkallë esenciale, ndërkaq nga rrethanat rëndësuese për të akuzuarin e lartcekur gjykata gjeti fillimisht se vepra penale e Lëndimit të lehte trupor është kryer brenda marrëdhënies familjare, ndaj bashkëshortes së tij, si dhe faktin se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra penale siç është armëmbajtje pa leje.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave të elaboruara me sipër, të njëjtit i shqiptoi dënimin unik si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje të plotë se me këtë dënim, i pandehuri do ta kuptojë rëndësinë e veprave të kryera penale dhe në këtë mënyrë i njëjtit do të reflektojë që në të ardhmen mos të shkaktojë veprime të ndaluara, përkatësisht mos të kryejë vepra penale, e çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së. Gjykata i shqiptoi një dënim unik me bindjen e plote se Gjykata se një dënim i tillë është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjesisë të pandehurit.

11. Vendimi mbi sanksionin penal dhe masën trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor

Gjykata krahas aktakuzës ka pasur edhe propozimin për masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri qendrën e shëndetit mendor në Pejë, dhe atë konform propozimit të Prokurores së Shtetit si në aktin akuzues, e duke u bazuar edhe në propozimin e ekipit të eksperteve në mendimin dhe propozimin e tyre përfundimtar.

Andaj, Gjykata krahas dënimit të shqiptuar kundër të akuzuarit, ka shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, pasi që ka vlerësuar se ky propozim është i bazuar dhe në përputhje të plote me nenin 86 të KPRK-së, duke pas parasysh gjendjen e shëndetit mendor të të akuzuarit dhe ka mbështetje edhe në provat dhe faktet që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata, duke marrë për bazë rrethanat dhe gjendjen e të pandehurit në momentin e kryerjes së veprës penale, si dhe çrregullimet mendore nga të cilat ai vuan, e të cilat çrregullime janë konstatuar nga ekipi i eksperteve, dhe po ashtu duke pas parasysh edhe rekomandimet dhe propozimin e ekspertës Dr. V. B. –R., ka gjetur se është e domosdoshme që të njëjtit ti shqiptohet

edhe masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Kjo me qëllim që i njëjti të rehabilitohet, dhe në këtë mënyrë të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, që i njëjti mos të kryejë vepra penale, të mos jetë i rrezikshëm për rrethinën ku jeton dhe në këtë mënyrë të eliminohet rreziku i përsëritjes së veprave penale.

Gjykata është e mendimit se me zbatimin e kësaj masës i njëjti do të përcillet dhe trajtohet nga ana e eksperteve të lemisë përkatëse dhe se gjendja e tij, mund të përmirësohet edhe më tej. Si një fakt posaçërisht i rëndësishëm, gjykata ka gjetur edhe gatishmërinë dhe motivin që e ka shfaqur edhe vet i pandehuri për rehabilitim, dhe po ashtu duke pasur parasysh edhe deklaratimet e tij gjatë dhënies së mbrojtjes së “unë kam qenë i sëmurë në kuptimin psikik” dhe “unë nga momenti i marrjes së terapisë nuk kam probleme, ndërsa përpara kam pas edhe kokëdhimbje”.

Gjykata në rastin konkret zbatoi nenin 18 par. 2, të KPRK-së⁴ si dhe nenin 515 par. 1, të KPPRK-së⁵, ku neni 515 par. 1 udhëzon në nenet 88 dhe 89 të KPRK-së, e të cilët nene janë identike me dispozitat e neneve 85 dhe 86 të Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës.

Nga dispozitat e lartcekura vijmë në përfundim se kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës, pra i njëjti gjykohej për veprën penale të cilën e ka kryer në gjendje të aftësisë të zvogëluar mendore në shkallen esenciale, por një gjendje tillë merret parasysh kur gjykata vendos për kohëzgjatjen e sanksionit penal ose masës së trajtimit të detyrueshëm.

Tutje konform nenit 515 paragrafi 1 të KPPRK-së, gjykata krahas aktgjykimit ndaj personit me aftësi të zvogëluar mendore, shqiptoi edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri (Qendrën e shëndetit mendor në Pejë), pasi që me këtë dispozitë është paraparë mundësia që krahas aktgjykimit dënues gjykata të shqiptoj edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.

Andaj gjykata konsideron se shqiptimi i një mase të tillë, është i domosdoshëm për të arritur tek rehabilitimi i të pandehurit në mënyrë që i njëjti mos ti përsëris veprimet e tilla.

Gjykata me rastin e shqiptimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në ndalim, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet nga neni 86 par.1, nën par.1.1, 1.2, 1.3 të KPRK-së, kështu që duke marr parasysh të gjeturat nga ekipi i eksperteve të IPFK-së, si dhe rekomandimet që rezultojnë nga ekspertiza e Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, dhe po ashtu sqarimet e dhëna në seancë nga Dr. V. B. R., gatishmëria dhe vullneti i të pandehurit për tu trajtuar, dhe mundësia që përmes këtij trajtimi që i njëjti të rehabilitohet dhe kështu të vazhdon jetën e tij, kanë bindur këtë gjykatë se kjo masë është e domosdoshme, andaj edhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

12. Përfundimi

⁴ *Personi i cili ka kryer veprë penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij/saj për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij/saj ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm.*

⁵ *Kur gjykata merr aktgjykim ndaj personit i cili ka kryer veprë penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, në atë aktgjykim ajo gjithashtu shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë nga nenet 88 dhe 89 të Kodit Penal.*

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, e konform nenit 43 të KPRK-së, gjykata e gjykoi të pandehurin si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 46, 47, 48, 49, të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi dënimin e kushtëzuar si në piken II.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi nëse i pandehuri dështon, refuzon apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin e shqiptuar me gjobë për veprën penale nga dispozitivi II të këtij aktgjykimi, është marrë konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për revokimin e dënimit me kusht nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit kryen veprë tjetër penale, është marrë konform nenit 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak në dënimin e shqiptuar është marrë konform nenit 79 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit plotësuese - konfiskimin e armës dhe shkatërrimin e saj, u morr konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së.

Gjykata konform dispozitës së nenit 457, 458 dhe 462 të KPRK-së, të dëmtuarit A. F. dhe B. M., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzon ne kontest te rregullt civil.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u morr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit NR.05/L-36.

Po ashtu, gjykata konform dispozitave të nenit 83, 84 dhe 86 të KPRK-së e lidhur me nenin 515 par. 1 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptoi masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri e cila do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart u vendos si në pjesën dënuese të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, e konform nenit 364 dhe nenit 515 par. 1 të KPRK-së.

Ndërsa, në kuptim të nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPRK-së, u vendos si në pjesën liruese të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.22/23 dt. 30.05.2023

Zyrtari ligjor,

Alan Taranish

Kryetari i trupit gjykues,

Murat Hulaj

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.